

OSBE ndihmon parashkollorët të mësojnë për të drejtat e njeriut

Fëmijët e moshës pesë dhe gjashtë vjeçare kanë filluar të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe jo-diskriminim përmes një projekti të OSBE-së në Kosovë, i cili ka për qëllim të ndihmojë edukatorët t'i integrojnë këto tema në planprogramin mësimor për më të vegjlit.

Vajza duke lozur në kuzhinën e improvizuar dhe djem duke lozur dhe imituar zhurmën e veturave lodra janë skena normale në kopshtet e fëmijëve në Kosovë, pasi që askujt nuk i duket se diçka e tillë nuk është në rregull. “Por këtu fillojnë stereotipet dhe ndarja e gjinive”, thotë Shahriniso Najmetdinova, këshilltare për të drejta të njeriut në misionin e OSBE-së në Kosovë.

Një nga detyrat e saj është të mbështesë punën e njësisë për të drejta të njeriut në Ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë në Kosovë. Ajo thotë se fëmijët deri në moshën gjashtë vjeçare nuk i zhvillojnë në mënyrë të plotë sjelljet e tyre, por i kopjojnë prindërit dhe mësuesit e tyre.

Sipas Znj. Najmetdinova problemi qëndron në faktin se edukatorët në Kosovë nuk ndjekin asnjë lloj trajnimi për të drejta të njeriut kështu që shumë lehtë mund t'i drejtojnë fëmijët gabimisht. “Ne e diskutuam këtë çështje me zyrtarët e ministrisë, dhe ata kërkuan që t'u ndihmojmë”, tha Najmetdinova.

Në fund të muajit prill, Misioni i OSBE-së ka organizuar një trajnim dy-ditor për 30 edukatorë nga të gjitha viset e Kosovës. Kursi ka përfshirë katër tema kryesore: të drejtat themelore të njeriut, të drejtat e fëmijëve, jo-diskriminimin dhe barazinë gjinore.

“Qëllimi ynë është t'i vetëdijësojmë edukatorët për çështjet kryesore të cilat janë shumë të rëndësishme gjatë punës me fëmijët”, thotë Iliriana Islami, trajnuese në misionin e OSBE-së.

Përqendrimi në të drejtat e fëmijëve

“Jemi përqendruar në mënyrë të veçantë në të drejtat e fëmijëve, përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta”, thotë Znj. Islami. “Kemi theksuar se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga shoqëria dhe duhet të ndjekin mësimin në shkolla të njëjta me fëmijët tjerë, çfarë nuk ka ndodhur deri më tani”.

Gjatë trajnimit janë adresuar edhe stereotipet për rolet gjinore. “Ne duam që fëmijët - duke filluar nga faza më e hershme e edukimit të tyre - të kuptojnë se detyrat dhe përgjegjësitë janë të njëjta për të gjithë, pa marrë parasysh gjininë”, thotë ajo.

Merita Gashi, edukatore në kopshtin e fëmijëve Buzëqeshja, e ka vlerësuar trajnimin si shumë të dobishëm. “Edhe pse kemi njohuri për temat që i kemi diskutuar gjatë trajnimit, gjithmonë është e dobishme të dëgjosh më shumë për çështjet që kanë të bëjnë me formimin e jetës së fëmijëve”, thotë ajo.

“Dhe gjithmonë ka vend për më shumë këshilla për mënyrën dhe gjuhën që duhet përdorur kur i mësojmë fëmijët se çka është mirë dhe çka është keq”.

Ndërrimi i rutinës

Qëkur ka marrë pjesë në trajnim, Merita ka ndërruar rutinën. “Tash kur vajzat shkojnë të luajnë në kuzhinë, ne i nxisim djemtë që edhe ata të luajnë të njëjtën lojë. Edhe lodrat nuk ua ndajmë – vetura dhe kukulla për të gjithë”.

Gati të pavetëdijshëm se po mësojnë për barazinë gjinore, tolerancën, dhe të drejtat e njeriut, fëmijët në klasën e edukatores Meritë janë të qeshur dhe më të interesuar për lojë se për të diskutuar të drejtat e njeriut.

Për të vazhduar suksesin e fazës së parë të trajnimit, misioni i OSBE-së është duke planifikuar trajnim të avancuar për të njëjtit edukatorë në muajin shtator. Përveç kësaj, gjatë këtij trajnimi do të identifikohen dy apo tre pjesëmarrës, të cilët pastaj do të trajnojnë edhe 493 edukatorët tjerë në Kosovë.

Shumë e bindur se kurrë nuk është mjaft me trajnime për ata të cilët punojnë me fëmijët, Merita mezi pret që të mbahet trajnimi i ardhshëm: “Do të kemi më shumë njohuri për të ndarë me fëmijët kur të filloj vitit i ri shkollor”.

Shkruar nga Mevlyde Salihu dhe Nikola Gaon